



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 18.04.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.04.2018 (ora 20:18) të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Eko Pastrimi" për aktivitetin: "Deratizimi i kanalizimit, bodrumeve dhe garazhave publike" dhe me numër të prokurimit: **616 -18-1347-211** nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Eko Pastrimi" e datës 18.04.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit " Deratizimi i kanalizimit, bodrumeve dhe garazhave publike" me Nr.616 18 1347 211 Nr. Brendshëm 616 18 036 211 kundër *Njoftimit për kontratë* të AK –së, të datës 09.03.2018, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet Njoftimi për kontratë i publikuar me datë: 09.03.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin*.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Eko Pastrimi" me datë 18.04.2018 ka parashtruar kërkesën-ankesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Deratizimi i kanalizimit, bodrumeve dhe garazhave publike" me Nr.616 18 1347 211 Nr. Brendshëm 616 18 036 211 ". Autoriteti Kontraktues, me datë 19.04.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

- 1.Lidhur me pretendimet për ndryshimet në kërkesat teknike,të njejtit OE-ik(sipas kërkesës së tij)dhe OE-ik tjerë u është dërguar përgjegjja,respektivisht sqarimet lidhur me këtë janë publikuar si shtojcë në E-prokurim me datat 28.03.2018 dhe

30.03.2018. Në sqarime kemi spjeguar qartë se kërkesat në dosjen e tenderit janë në përputhmëri me natyrën e shërbimeve të kërkuara dhe nuk mund të ndryshohen; dhe 2. Arsyeja tjetër e refuzimit të kërkesës qëndron në faktin se kërkesa-ankesa është dërguar pas skadimit të afateve kohore të parapara për paraqitjen e kërkesave për rishqyrtim dhe pas afateve ligjore që lejojnë vazhdimin e afateve për hapjen e tenderëve.

Prandaj nuk ka arsye dhe bazë ligjore që të pranohet si e ligjshme ankesa e pretenduesit "Eko Pastrimi" dhe aktiviteti do të vazhdojë sipas dispozitave ligjore, respektivisht, hapja e tenderit do të bëhet në kohën e caktuar në Njoftimin për kontratë dhe në FDT-në e Dosjes së tenderit. Përgatitja dhe dorëzimi i tenderëve janë e drejtë e secilit OE-IK të interesuar, ndërsa natyrisht fituesi i tenderit do të përcaktohet në harmoni me kërkesat e Dosjes së tenderit. Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në sqarimet dhe konstatimet e paraqitura më lartë ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit